



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 nëntor 2013, miratoi këtë:

Rregullore

për skemën e debitimit direkt të sistemit elektronik të kliringut ndërbankar

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i Rregullores për skemën e debitimit direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (tani e tutje “Rregullorja”) është të përcaktojë parimet dhe kërkesat bazë në lidhje me funksionimin e kësaj skeme (tani e tutje “Skema e Debitimit Direkt”). Në kuadër të Rregullores përfshihen dispozitat kryesore, që aplikohen për anëtarët e Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) dhe akterët e tjerë të përfshirë në Skemën e Debitimit Direkt.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përkufizuar në Ligjin për BQK-në, Ligjin për sistemin e pagesave dhe siç janë përkufizuar më poshtë në këtë Rregullore:
 - 1.1. “*Bankë destinuese*” do të thotë banka e identifikuar në urdhërpagesën në të cilën i bëhet pagesa të paguarit në një transfer të kredisë ose mbahet llogaria e një paguesi në një transfer debiti.
 - 1.2. “*Bankë iniciuese*” do të thotë banka e cila pranon urdhërpagesën e parë që inicion një transaksion pagese.
 - 1.3. “*Bankë pranuese*” do të thotë banka të cilës i adresohet urdhërpagesa e dërguesit.
 - 1.4. “*Dërgues*” do të thotë personi fizik apo juridik që i jep një urdhërpagesë një banke pranuese.
 - 1.5. “*I paguari*” do të thotë pala që duhet të pranojë pagesën në një transaksion pagese.

- 1.6. *“Iniciator”* do të thotë dërguesi i urdhërpagesës së parë që inicion një transaksion të pagesës.
- 1.7. *“Klient”* do të thotë një person fizik apo juridik, duke përfshirë edhe një bankë e cila ka të hapur një llogari bankare në një bankë tjetër.
- 1.8. *“Llogari bankare”* do të thotë çdo llogari e hapur në një bankë në bazë të një kontrate të lidhur ndërmjet një klienti dhe bankës, qoftë ajo llogari rrjedhëse, xhirollogari ose llogari tjetër dhe përfshin një llogari sipas një marrëdhënie të veçantë të krijuar vetëm për qëllim të realizimit të një urdhërpagese.
- 1.9. *“Pagues”* do të thotë pala e cila duhet të bëjë transaksionin e një pagese.
- 1.10. *“Pranues”* do të thotë personi fizik apo juridik, banka e të cilit duhet ta marrë urdhërpagesën e fundit në një transaksion pagese.
- 1.11. *“SEKN”* do të thotë Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar.
- 1.12. *“Transaksion i pagesës”* do të thotë transfer i fondeve nga llogaria bankare e paguesit te i paguari ose llogaria bankare e të paguarit. Paguesi dhe i paguari mund të jenë persona të njëjtë ose dy persona të ndryshëm fizik a juridik. Transaksioni i pagesës mund të jetë një transfer krediti ose debiti i fondeve dhe inicohet me urdhërpagesën e iniciatorit që i jepet bankës iniciuese, duke urdhëruar atë që ta kryejë transaksionin e pagesës.
- 1.13. *“Transfer i debitit”* do të thotë një transaksion i pagesës i iniciuar nga urdhërpagesa e të paguarit, sipas autorizimit të paguesit, me të cilën nëpërmjet bankës së të paguarit urdhërohet banka e paguesit për t’i tërhequr paratë nga llogaria e paguesit.
- 1.14. *“Transfer ndërbankar”* do të thotë transfer i fondeve nga paguesi tek i paguari në dy banka të veçanta, ku paraqiten së paku dy urdhërpagesa, ku secila bankë pranuese përveç bankës destinuese në kryerjen e urdhërpagesës së dërguesit të vet i lëshon një urdhërpagesë korresponduese bankës pranuese dhe ku urdhërpagesa e fundit i dërgohet bankës destinuese. Pjesëmarrës në një transfer ndërbankar janë iniciatori, banka iniciuese, banka destinuese dhe pranuesi dhe mund të përfshijë një ose më shumë banka ndërmjetësuese. Në një transfer ndërbankar, përveç veprimt në emër të klientit, banka mund të veprojë në emër dhe për llogari të vet.
- 1.15. *“Udhëzim”* nënkupton një rekomandim me shkrim të lëshuar nga Banka Qendrore që ka aplikim të përgjithshëm dhe është i detyrueshëm në tërësinë e tij dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm “.
- 1.16. *Urdhërpagesë”* do të thotë çdo udhëzim nga paguesi apo i paguari dhënë institucionit të tij ose të saj të pagesave ku kërkohet ekzekutimi i transaksionit të pagesave.

Neni 3

Transferi i Debitimit Direkt

Transferi i debitimit direkt që realizohet përmes Skemës së Debitimit Direkt, është një transfer i debitit. Në transferin e debitimit direkt, nisësi (iniciatori) është i paguari, bankë

nisëse (iniciuese) është banka e të paguarit, bankë pranuese është banka e paguesit dhe pranues i transferit të Debitimit Direkt është paguesi.

Neni 4

Bankat Anëtare të Skemës së Debitimit Direkt

Bankat anëtare të Skemës së Debitimit Direkt janë bankat komerciale anëtare të SEKN- së. Përveç kur është përcaktuar ndryshe në këtë Rregullore dhe në Udhëzimin e Operimit të Skemës së Debitimit Direkt, për veprimet dhe përgjegjësitë e bankave anëtare në SEKN mbasin efektive rregullat dhe procedurat e SEKN-së.

Neni 5

Pjesëmarrësit në Skemën e Debitimit Direkt

1. Pjesëmarrës në Skemën e Debitimit Direkt janë personat juridikë dhe fizikë, që janë të përfshirë drejtpërdrejt në operimin e Skemës së Debitimit Direkt siç është përcaktuar më poshtë. Këta janë:
 - 1.1. I Paguari (Nisësi i Urdhërpaguesës Ndërbankare) është pala pjesëmarrëse në Skemën e Debitimit Direkt, që dërgon urdhërpaguesën me të cilën nisët transferi i debitimit direkt dhe që duhet të pranojë pagesën (mjetet e paguara) në transferin e debitimit direkt. Kjo palë duhet të jetë e autorizuar paraprakisht si nga BQK-ja për pjesëmarrje në Skemën e Debitimit Direkt ashtu edhe nga paguesi për debitimin e llogarisë së tij/saj. Si palë e këtillë pjesëmarrëse mund të jetë edhe një bankë anëtare e Skemës së Debitimit Direkt.
 - 1.2. Paguesi (Pranuesi i Urdhërpaguesës Ndërbankare) është pala pjesëmarrëse në Skemën e Debitimit Direkt banka e së cilës duhet ta marrë urdhërpaguesën në transferin e debitimit direkt dhe pala e cila duhet të bëjë pagesën, përkatësisht t'i debitohet llogaria, në transferin e debitimit direkt. Kjo palë duhet t'i ketë dhënë autorizimin të paguarit (nisësit) paraprakisht për debitimin e llogarisë së vet. Si palë e këtillë pjesëmarrëse mund të jetë edhe një bankë anëtare e Skemës së Debitimit Direkt.
 - 1.3. Banka e të Paguarit (Banka Nisëse) është pala pjesëmarrëse në Skemën e Debitimit Direkt – banka e cila pranon urdhërpaguesën nga i paguari me të cilën nisët transferi i debitimit direkt. Në këtë bankë i paguari e mban llogarinë, e cila në transferin e debitimit direkt kreditohet.
 - 1.4. Banka e Paguesit (Banka Pranuese) është pala pjesëmarrëse në Skemën e Debitimit Direkt – banka e cila e pranon urdhërpaguesën nga banka e të paguarit në transferin e debitimit direkt. Në këtë bankë paguesi e mban llogarinë, e cila në transferin e debitimit direkt debitohet.
 - 1.5. BQK-ja si pronare dhe operuese e SEKN-së e kontrollon funksionimin e Skemës së Debitimit Direkt. Njëherësh, BQK-ja mund të marrë pjesë në Skemën e Debitimit Direkt edhe në cilësitë e palëve të tjera pjesëmarrëse.

Neni 6

Përgjegjësitë e pjesëmarrësve

1. Banka e iniciuesit/kreditorit duhet të:
 - 1.1. I përmbahet kësaj rregulloreje dhe udhëzimit të operimit të Skemës së Debitimit Direkt.
 - 1.2. Sigurojë që iniciuesit/kreditorët për të cilët grumbullojnë fondet janë të njoftuar me rregulloren dhe udhëzimin e operimit të Skemës së Debitimit Direkt
 - 1.3. Sigurohet se skedat (*fajllat*) me të dhëna janë procesuar në pajtim me procedurat dhe brenda afateve kohore të definuar në udhëzimin e operimit të Skemës së Debitimit Direkt..
 - 1.4. Sigurohet që kërkesat për zhdëmtim/ankesat të zgjidhen sipas afateve të përcaktuara në udhëzim
 - 1.5. Sigurohet që banka e paguesit të rimbursohet për kërkesat për zhdëmtim të palës së pakënaqur.
 - 1.6. Ndërmarrë hapat dhe veprimet e duhura me kreditorët të cilët nuk i përmbahen rregullave.
 - 1.7. Sigurohet që debitimi direkt është ekzekutuar vetëm në përputhje me udhëzimet e klientit.
2. Iniciuesi/Kreditori duhet të:
 - 2.1. Sigurojë që njoftimi i rregullt mbi shumën dhe data e tërheqjes i është dërguar klientit (paguesit) sipas afateve të përcaktuara në udhëzim .
 - 2.2. Sigurojë që debitimi direkt është iniciuar në bazë të udhëzimeve dhe rregullores së skemës së debitimi direkt.
 - 2.3. Sigurojë që shumat të cilat klienti i konteston të mos procedohen.
 - 2.4. Sigurojë që të gjitha anulimet të përpunohen me kohë.
 - 2.5. Sigurojë që të gjitha kërkesat (ankesat për zhdëmtim do të zgjidhen brenda 10 ditëve.
 - 2.6. Sigurojë që i është përmbajtur të gjitha përgjegjësi të kreditorit sipas rregullores së Skemës së Debitimit Direkt.
 - 2.7. Sigurojë që procedurat për përfundimin /mbylljen e debitimit direkt janë duke u zbatuar dhe janë funksionale.
3. Banka e paguesit duhet të:
 - 3.1. T'i përmbahet udhëzimit dhe procedurave të operimit të Skemës së Debitimit Direkt
 - 3.2. Paguajë debitimin direkt vetëm në pajtim me autorizimin e dhënë nga klienti dhe të përcaktuar detalisht në udhëzimin operacional.
 - 3.3. Sigurojë që debitimi direkt i paautorizuar apo i anuluar të ndërpritet dhe të kthehet menjëherë pas njoftimit.
 - 3.4. Me kohë të prezantojë kërkesat për zhdëmtim të cilat dalin në bazë të skemës së debitimit direkt.
 - 3.5. Me kohë të refundojë klientin për kërkesat (ankesat për zhdëmtim dhe të paraqesë kërkesën për zhdëmtim/ankesën bankës së kreditorit.
 - 3.6. Ndihmojë klientin në zgjidhjen e mospajtimit me kreditorin.
 - 3.7. Informojë bankën e kreditorit në rastet kur kreditori nuk u përmbahet rregullave të skemës.
4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

- 4.1. Si rregullator në fushën e sistemeve të pagesave definojnë dhe përcaktojnë rregullat, procedurat dhe përgjegjësitë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në skemën e Debitimit Direkt në Kosovë.
- 4.2. Operon me Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), duke përfshirë edhe modulën për debitim direkt.
- 4.3. Mirëmbajtë dhe sigurojë që skema të ofrojë dhe të posedojë standarde të larta të efikasitetit, besimit, sigurisë dhe integritetit.
- 4.4. Definojnë dhe përcaktojnë procedurat operacionale dhe teknike për debitim direkt
- 4.5. Përcaktojnë detyrimet dhe të drejtat si dhe përpilon marrëveshjet përkatëse për anëtarësim në Skemën e Debitimit Direkt.
- 4.6. Përcaktojnë detyrimet dhe të drejtat si dhe përpilon marrëveshjet përkatëse për pjesëmarrje të kreditorëve në Skemën e Debitimit Direkt
- 4.7. Mirëmban regjistrin e kreditorëve, lëshon kodin identifikues të kreditorëve si dhe informon pjesëmarrësit për ndryshimet dhe plotësimet në atë bazë të të dhënave.
- 4.8. Informon bankat dhe pjesëmarrësit e tjerë lidhur me Skemën e Debitimit Direkt, sipas nevojës.

Neni 7

Udhëzimi i Operimit të Skemës së Debitimit Direkt

Brenda suazave dhe kërkesave të specifikuar në këtë Rregullore si dhe në përputhje me Ligjin për BQK-në dhe Ligjin për sistemin e pagesave, Bordi Ekzekutiv i BQK-së nxjerr Udhëzimin e operimit të Skemës së Debitimit Direkt.

Neni 8

Tarifat

Tarifat mbi shërbimet e ofruara nga bankat për transferet e debitimit direkt, mbulohen nga iniciuesi/kreditori apo caktohen me marrëveshje në mes kreditorëve dhe bankave pjesëmarrëse në skemën e debitimit direkt.

Tarifat për kliring dhe shlyerje të transaksioneve të debitimit direkt miratohen nga BQK-ja krahas "Tarifave të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar".

Neni 9

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet

Çdo shkelje e kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave ndëshkuese siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për sistemin e pagesave.

Neni 10
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulla XXXI mbi Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar, e miratuar më datë 30 dhjetor 2008 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2014.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Mejdi Bektashi